



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS
VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO

MINISTRIA PER EKONOMI DHE FINANCA
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANCIJE
MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE
ZYRA E MINISTRIT / KANCELARIJA MINISTRA / CABINET OF THE MINISTER

DATE/A:	19 Maj 2009
PËR/ZA/TO:	Kryetarët e Komunave Drejtorët për Buxhet dhe Financa Drejtorët e Drejtorive
CC:	Naim Baftiu, u.d. sekretar i përhershëm, MEF
NGA/OD/FROM:	Ahmet Shala, Ministër
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkore Buxhetore 2010/01 për Komunitat, Financimi nga grantet qeveritare dhe kufijtë fillestarë buxhetor për buxhetin e propozuar të komunave dhe kërkesat për ndarje buxhetore për vitet 2010-2012

Të nderuar Kryetarë të Komunave,

Përmes kësaj Qarkore Buxhetore 2010/01 për Komunitat ju njoftoj për zhvillimin e procesit buxhetor komunal bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2010-2012 mbi financimin e propozim buxheteve komunale nga grantet qeveritare të cilat janë aprovuar nga Komisioni i Granteve në pajtim me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal.

Qëllimi

Qarkorja buxhetore 2010/01 për komunitat ofron udhëzimet e para, kalendarin kohor indikator si dhe kufijtë fillestarë të përgatitjes së buxhetit të propozuar komunal dhe kërkesës për ndarje buxhetore (në vijim e referuar si Buxheti Komunal) për vitet 2010-2012 sipas Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL).

Qëllim i këtij dokumenti është të informojë komunitat për financimin komunal në bazë të vendimeve të marra nga Komisioni i Granteve më 21 prill 2009, dhe në pajtim të plotë me Kornizën afatmesme të shpenzimeve (KASH) për periudhën 2010-2012, që rregullon

financimin komunal përmes granteve qeveritare të dedikuara për financimin minimal të kostos së shërbimeve komunale.

Nga ju kërkohet ta shpërndani këtë qarkore me të gjithë stafin e përfshirë në procesin buxhetor të komunës, dhe në përgatitjen e kornizës afatmesme buxhetore komunale (KABK) duke vazhduar me nxjerrjen e qarkores interne buxhetore komunale si bazë për planifikimin e buxhetit tuaj komunal për vitin 2010.

Kjo Qarkore do të jetë e para në serinë e qarkoreve që do të sigurojnë informata për komunat lidhur me zhvillimin e procesit buxhetor komunal për vitet 2010-2012.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesës së Qeverisë për përgatitjen e projektbuxhetit në kohën e duhur dhe që është më i përgjegjshëm në aspektin fiskal, është thelbësore që të gjitha komunat të veprojnë në pajtim me afatet kohore dhe kërkesat e specifikuar në këtë dhe qarkoret tjera pasuese buxhetore si dhe në përputhje me dispozitat e aplikueshme në fuqi.

Nëse paraqiten pyetje lidhur me udhëzimet në këtë qarkore, zyrtarët komunal mund të konsultohen me analistët e tyre përkatës në Departamentin e Buxhetit Komunal në Ministrinë për Ekonomi e Financa (MEF).

1. Hyrje

Sistemi i financimit komunal ka pësuar ndryshime të mëdha në vijën horizontale dhe vertikale të ndarjes. Parimet e financimit komunal dhe pjesëmarrja e buxhetit Komunal në Buxhetin e Republikës së Kosovës (transferet qeveritare për komunat) janë strukturuar në linjë me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL).

Duke u nisur nga përvojat e viteve të kaluara dhe me qëllim të vazhimit të reformave të procesit buxhetor, buxheti komunal për vitin 2010 do të ndërtohet sipas: **strukturës bazë të programeve**.

Për të përmirësuar gjithë-përfshirjen, transparencën dhe kredibilitetin e formulimit të buxhetit komunal, synohet që hartimi i buxhetit komunal të ndërtohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi:

- Ligji për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe,
- Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) .

2. Financimi Komunal nga grantet qeveritare për vitin 2010-2012

Parimet kryesore që rregullojnë përcaktimin dhe ndarjen e secilit prej granteve qeveritare për komunat ¹ si dhe shumat agregate janë gjithashtu në pajtim me LFPL.

¹ Përshkrimi dhe qëllimi për secilin grant qeveritar dhe elementet e formulës do të gjeni të bashkangjitur në aneks të kësaj qarkore buxhetore.

Grantet qeveritare për komuna bazohen në kritere të drejta, transparente dhe objektive duke ju dhënë kështu komunave autoritet më të madh në vendimet e tyre për shpërndarjen dhe shpenzimin e fondeve. Si të tilla grantet komunale janë si më poshtë:

- Granti i Përgjithshëm, i parashikuar për financim të shërbimeve në pajtim me kompetencat komunale ;
- Granti specifik i Arsimit, me sistem të hapur i cili do të financoj koston e ofrimit të nivelit minimal të standardeve në arsimin parauniversitar dhe
- Granti specifik i Shëndetësisë, i cili do të financoj koston e ofrimit të nivelit minimal të standardeve në kujdesin shëndetësor parësor.

Tabela 1. Financimi komunal agregat për vitet 2010-2012

Grantet dhe të hyrat komunale	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012
Granti i Përgjithshëm	94.26	99.3	104.4
Granti specifik për Shëndetësi	24.81	25.4	26.1
Granti specifik për shërbime sociale	1.80	2.0	2.2
Granti specifik për Arsim	109.10	111.0	114.0
Totali i financimit të granteve	229.97	237.78	246.67
Të hyrat vetanake	50.40	52.0	53.5
Total Financimi Komunal nga Grantet dhe të hyrat	280.4	289.8	300.2

Sqarim: Të hyrat vetanake të komunave janë projeksione të planifikuara nga vet komunat..

3. Të Hyrat Vetanake komunale për vitet 2010-2012

Komunat i kanë ofruar MEF-it projektimet e tyre për të Hyrat Vetanake të planifikuara për tre vitet e ardhshme. Këto projektme janë inkorporuar në parashikimin e të hyrave në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2010-2012. Prandaj, komunat këshillohen të përdorin këto projektme për qëllim të planifikimeve të shpenzimeve buxhetore për periudhën 2010-2012 (shih Shtojcën D, referuar projektmeve të të hyrave vetanake që ka ofruar komuna juaj). Në rast të ndryshimit të projektimit të të hyrave vetanake, komunat janë të obliguara të informojnë MEF-in në lidhje me parashikimet e tyre përfshirë ndarjen në kategori të të hyrave, si dhe mbështetja e supozimeve që rezultojnë në një projektim të ri.

Sipas projeksioneve agregate të komunave për të hyrat vetanake për vitin 2010 në shumën prej 42.3 milion euro, ku parashihet një rritje prej 13.5 % krahasuar me vitin 2009 (37.2 milion euro të hyrat vetanake të komunave të aprovuara me buxhetin e vitit 2009).

Të hyrat vetanake komunale për vitin 2010 dhe projeksionet për vitet 2011-2012 përfshijnë të hyrat vetanake të planifikuara nga vet komunat, dënimet e trafikut dhe gjobat e shqiptuara nga gjykatat.

4. Parimet për përgatitjen e buxhetit komunal 2010-2012

4.1. Kufijtë fillestarë të financimit nga grantet qeveritare

Komisioni i Granteve ka aprovuar kufijtë fillestarë të financimit komunal për vitin 2010 si dhe vlerësimet për dy vitet e ardhshme 2011-2012, që përfshin grantin e përgjithshëm, grantin specifik për shëndetësi, grantin specifik për arsim dhe grantin specifik për shërbime sociale. Këta kufij fillestarë për komunën tuaj janë të publikuar në faqen zyrtare të MEF-it

(linku i Komisionit të Granteve), gjithashtu dhe në **Shtojcën B**. Përveç kësaj, Komunitat do të jenë pranuese të grantit specifik për ofrimin e shërbimeve sociale në pajtim me transferin e kompetencave që është bërë në fillim të vitit 2009.

Nga komunitat kërkohet të planifikojnë buxhetet e tyre për tri vitet e ardhshme dhe t'ju përmbahen nivelit të granteve si në Shtojcën B, qëllimit dhe strategjisë së financimit nga secili lloj i granteve të dhënë në **Shtojcën C** si dhe planifikimit të të hyrave vetanake në **Shtojcën D**.

4.2. Kufijtë fillestarë të shpenzimeve buxhetore

Kufijtë e shpenzimeve buxhetore për vitin 2010 për nivelin Komunal janë vendosur nga MEF-i në bazë të këtyre parimeve:

- a. Autoriteti sipas Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal,
- b. Synimi i qeverisë për implementim të politikës për qëndrueshmërinë fiskale dhe
- c. Zotimi i Qeverisë për të ju përmbajtur rregullës fiskale sipas dokumentit të KASH-it dhe rekomandimeve të FMN-së.

Si rrjedhojë e pikave të lartcekura, maksimumi i rritjes së lejueshme të shpenzimeve të buxhetit operativ do të jetë i kufizuar deri në shkallën e rritjes reale prej 0.5% krahasuar me buxhetin e vitit 2009.

Megjithatë, janë bërë disa përjashtime nga aplikimi i rregullës fiskale për shkak të disa vendimeve të qeverisë të bazuara nga prioritetet si:

- Punësimi i mësimdhënësve shtesë (vendimi i qeverisë)
- Transferimi i kompetencave nga MPMS në nivelin komunal
- Implementimi i kostos së udhëzimit administrativ për pagesën e stafin politik në komuna
- rritja e numrit të stafit në arsimin parauniversitar për 40 pedagogë (dyzetë) me koston financiare prej 150,000 euro (financimi përkatës do të bëhet nga granti i përgjithshëm i komunës).

Do të ketë gjithashtu kufizime në kategorinë e **Pagave dhe Mëditjeve** që duhet të respektohen nga të gjitha komunitat për shpenzimet në paga dhe mëditje. Të vetmet komuna që do të kenë përjashtim janë komunitat e reja që janë krijuar së fundi (Mamusha, Juniku dhe Hani i Elezit).

Çështja e stafit dhe buxhetit operativ në arsim dhe shëndetësi është subjekt i ndryshueshëm për shkak të prekjes së komunave nga procesi i decentralizimit.

Komunitat e prekura janë: Gjilani, Kamenica, Novobërda, Mitrovica, Prishtina, Lipjani, Fushë Kosovë dhe Viti.

Shumat e reflektuara në tabelat e granteve janë kalkuluar në bazë të Ligjit për Kufijtë Administrativ Komunal. Varësisht nga progresi në implementimin e këtij ligji që mbështetet nga MAPL, kufijtë fillestar (buxheti operativ, fatura e pagave dhe stafi) mund të ndryshoj. MEF-i do të informoj komunitat e prekura nga procesi i decentralizimit, dhe do të ri-rregullojë ndryshimet e reflektuara në staf dhe buxhetin operativ për vitin 2010.

Resurset nga financimi komunal përfshirë grantet dhe të hyrave vetanake komunale që e kalojnë kufirin e lejuar të buxhetit operativ (rrjedhëse) do të duhej të ndahen në kategorinë e shpenzimeve kapitale.

Kategoria e Shpenzimeve kapitale do të ketë rritje, në krahasim me vitin 2009 si rezultat i rritjes së grantit të përgjithshëm. Të gjitha shpenzimet kapitale duhet të jenë në përputhje me definicionin e “kapitaleve” të dhënë në udhëzimet e thesarit. Mos përmbushja e këtyre definicioneve gjatë planifikimit në buxhetin komunal do të rezultojë me vështirësi në ekzekutimin e projekteve.

Rekomandohet që gjatë hartimit të projekteve kapitale për vitin 2010, secili projekt duhet të përmbajë edhe pjesën e shpenzimeve operative që është pjesë e atij projekti. Projektet kapitale duhen të hartohen në formatin përkatës duke marrë për bazë format elektronike të PIP-it.

Përparësi për financim duhet të kenë projektet në vazhdim që janë iniciuar në vitet paraprake dhe ato të cilat janë në harmoni të plotë me prioritet e Komunës të aprovuara nga Kuvendi i Komunës, e të cilat kanë deklaruar arsyeshmëri të plotë për financim. Komunitat duhet të tregojnë se si propozimet e tyre do të kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë lokale, krijimin e vendeve të reja të punës, ngritjen e mirëqenies së qytetarëve.

Gjatë zhvillimit të buxhetit të propozuar të komunave dhe kërkesave për ndarjen buxhetore për vitin 2010 kërkohet nga komunitat që në mënyrë strikte ti respektojnë kufijtë fillestarë të shpenzimeve që janë të pasqyruar në **Shtojcën H**.

4.3. Struktura e buxhetit komunal

Struktura e buxhetit komunal është e njëjta sikur se në vitin e kaluar bazuar në planin kontabël dhe buxhetimin e programeve. Komunitat gjatë hartimit të buxhetit mund të vendosin ti përdorin të gjitha nën-programet, ose numër të caktuar të tyre, varësisht nga sfera e aktiviteteve dhe funksioneve të tyre. Komunitat do të kenë fleksibilitet për zhvillimin e nën-programeve të tyre nëse ka nevojë, ndërsa që në këtë rast do t’ju jepen kodet korresponduese. Nën-programet do të shfrytëzohen për formulimin dhe ekzekutimin e buxhetit (përfshirë edhe raportimin) pa kufizime në lëvizjen e mjeteve (transferet) në mes të nën-programeve brenda të njëjtit program.

Të gjitha nën-programet për të cilat komunitat e formulojnë buxhetin do të prezantohen në tabelat buxhetore për qëllime informative.

Në bazë të përvojës së mëhershme, komunitat janë të obliguara të formulojnë dhe dorëzojnë buxhetin e tyre, të ekzekutojnë dhe raportojnë për nën-programet e definuara në shëndetësi dhe arsim për të llogaritur në nivelet specifike të ofrimit të shërbimeve, p.sh: arsimit parashkollor, fillor dhe i mesëm apo në nivelin e shkollave si në pilot projektin e komunave për vitin 2009 për Gjilan, Istog dhe Kaçanik.

Buxhetet komunale për vitin fiskal 2010 do të përgatiten sipas pesë kategorive ekonomike për shpenzimet e buxhetuara, në pajtim me rregullat financiare për shpenzimet (SIMFK) të nxjerra nga Thesari, si vijon: Paga & Mëditje, Mallra & Shërbime, Shpenzime komunale, Subvencione & Transfere dhe Shpenzime kapitale

4.4. Vlerësimet e hershme

Vlerësimet e hershme janë element kyç i përgatitjes së projeksioneve buxhetore për vitin 2010 dhe do të shërbejnë si bazë për vitet 2011 dhe 2012. Vlerësimet e hershme janë veçmas të domosdoshme për shqyrtimin e duhur të shpenzimeve operative dhe atyre kapitale.

Komunat duhet të kenë parasysh gjatë vlerësimeve të hershme:

- Legjislacionin me ndikimet financiare;
- Projektet që janë në vazhdimësi të cilat bartin obligime financiare në vitin 2010 dhe vitet pasuese.

4.5. Korniza Afatmesme Buxhetore për Komuna (KAB Komunal)

Rekomandohet që Komunat të shfrytëzojnë modelin e KAB komunal nga përvoja e viteve paraprake dhe të mbështesin procesin e tyre buxhetor komunal për vitin 2010 në Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale. KAB Komunale duhet të përcaktojë me sa vijon për tri vitet vijuese fiskale:

- (a) Parashikimet dhe supozimet ekonomike dhe buxhetore
- (b) Strategjia zhvillimore e komunës
- (c) Vlerësimin agregat të të hyrave nga të gjitha burimet, përfshirë këtu transferet qeveritare, në pajtim me shumat e njoftuara nga Ministria për Ekonomi dhe Financa, si dhe të hyrat vetanake komunale duke përfshirë edhe participimin e qytetarëve, në pajtim me parashikimet buxhetore që i përmban KAB Komunale
- (d) Caqet agregate (të përgjithshme) për shpenzime në të gjitha programet sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve
- (e) Vlerësimet e përkrahjes së pritur nga donatorët e jashtëm dhe agjencionet ndërkombëtare qeveritare, përfshirë bashkëfinancimin nga IPA, etj.

Gjatë zhvillimit të draftit të KAB komunale, komuniteti dhe palët kyçe të përfshira në proces duhet të konsultohen, përfshirë këtu takimet publike për diskutimin e prioriteteve dhe strategjive komunale. Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) duhet gjithashtu të mbajë takime publike për ti diskutuar prioritetet dhe strategjitë para aprovimit të këtij dokumenti. Dokumenti i aprovuar i KAB Komunale duhet të publikohet për të qenë në dispozicion të publikut dhe një kopje t'i dërgohet Departamentit të Buxhetit Komunal në MEF.

4.6. Buxhetimi i bazuar në programe dhe performansë

Procesi buxhetor komunal i vitit 2010 do të vazhdoj me zbatimin e buxhetimit programor në nivelin e programeve. Fokusimi do të jetë mbi objektivat, strategjitë, produktet dhe rezultatet e synuara nëpërmes të procesit buxhetor. **Shtojca J** ofron formularët për misionin dhe performansën e buxhetit, përfshirë këtu masat e thjeshta të performansës, që komunat do të duhej ti zhvillojnë dhe sigurojnë për secilën program.

Buxheti komunal për Kujdesin Shëndetësor Primar (KShP) edhe për vitin 2010 do të vazhdojë të përfshijë një mekanizëm të pagesës për performansën që synon të sigurojë një bazë më të drejtë dhe më të barabartë për pagesën e KShP. Objektivi është të stimulohet performansa e ofruesve të shërbimeve shëndetësore dhe të inkurajohen përmirësimet në cilësinë, efikasitetin dhe efektshmërinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe pagesa e bazuar në performansë do të përbëjë 5% të Grantit total për shëndetësi për secilën komunë.

Shuma prej 5% për performansë nga totali i grantit specifik të shëndetësisë shpërndahet në kategori ekonomike si vijon: 60% në paga dhe mëditje dhe 40% në mallra dhe shërbime.

4.7. Programi i Investimeve publike (PIP)

Sistemi i PIP-it bazohet në formularët të cilët janë përdorur gjatë vitit 2009 nga komunat për arsyetimin e projekteve kapitale. Shfrytëzimi i proceseve të avancuara është i nevojshëm për arsyetim të plotë të buxheteve të projekteve - për të paraqitur problemet aktuale të cilat duhet të adresohen në situatën ekzistuese, për të siguruar se merren parasysh opsionet para-përvlerë për adresimin e problemeve, për të siguruar planifikim të mirë të projekteve dhe për të parashikuar se sigurimin e kostove për përkrahjen e implementimit të projektit si dhe për kostot periodike pas përfundimit të projektit.

Shfrytëzimi i sistemit është i domosdoshëm për integrimin e proceseve të planifikimit dhe zhvillimit të buxheteve për BK, për të lehtësuar raportimin dhe prodhimin e raporteve të buxhetit dhe në fund të këtij viti për të raportuar dhe monitoruar implementimin e projektit (dhe ekzekutimit të buxhetit). BDMS-ja nga ky vit e tutje nuk do të lejojë futjen e buxheteve të projekteve kapitale, mirëpo të dhënat nga Sistemi i PIP-it do të ndërlidhen me BDMS-në në mënyrë që projektet të raportohen nga BDMS-ja por të mos futen atje. Prandaj, sistemi i PIP-it duhet të përdoret për zhvillimin e buxhetit të projekteve kapitale.

Pas miratimit të projekteve, shumat e buxhetuara dhe hollësitë e shkurtra të projektit do të futen në BDMS përmes një ndërfaqe të automatizuar.

Ju lutem kontaktoni analistin tuaj të buxhetit komunal ose tavolinën ndihmëse të PIP-it për çfarëdo pyetje në lidhje me procesin dhe sistemin e PIP-it.

4.8. Sistemi për menaxhimin e të dhënave buxhetore (BDMS)

Sistemi i menaxhimit të të dhënave buxhetore është instaluar dhe është në dispozicion për shfrytëzim nga Komunat për futjen e buxhetit të Aprovuar për një vit fiskal. Po qe se është e nevojshme të gjitha komunave do t'ju ofrohet trajnimi për përdorimin e sistemit, për të siguruar që zyrtarët përgjegjës komunal të kuptojnë si përdoret sistemi. Të gjitha komunat do të obligohen të bëjnë futjen e të dhënave në BDMS në mënyrë të pavarur. Në rastet kur komunat nuk e shfrytëzojnë sistemin BDMS, do të ndeshen me probleme në sigurimin e fondeve të tyre të buxhetuara.

Nëse keni pyetje apo probleme lidhur me përdorimin e BDMS, inkurajohen të kontaktojnë me analistët e tyre të buxhetit në Departamentin e Buxhetit Komunal ose tavolinën ndihmëse.

4.9. Fazat e procesit buxhetor komunal 2010-2012

Pjesa në vijim prezanton kalendarin kohor të buxhetit komunal dhe ofron një përmbledhje të hapave dhe veprimeve që kërkohen gjatë procesit buxhetor komunal 2010-2012.

Hapi 1: Themelimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale

Eshtë e rekomanduar që hapi i parë në zhvillimin e buxhetit komunal 2010-2012 do të ishte themelimi i Kornizës afatmesme buxhetore komunale (KAB komunale). Ky dokument do të jetë një dokument i niveli të lartë strategjik i cili do të paraqesë vendimet komunale lidhur me caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve si dhe mënyrën se si do të bëhet alokimi në mes kategorive kryesore ekonomike, për të përmbushur strategjinë zhvillimore afatmesme të komunës.

Aktivitetet:

1. Zyrtari kryesor financiar i drejtuar nga kryetari e zhvillon draftin e KAB komunale, dhe kryetari e dorëzon ne Kuvendin Komunal,
2. Konsultimet do të mbahen me komunitetin dhe palët kyçe të përfshira, përfshirë këtu takimet publike për të diskutuar lidhur me prioritetet dhe strategjitë e komunës,
3. Kuvendi Komunal e shqyrton, amandamenton nëse është e nevojshme dhe aprovon Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale,
4. KAB Komunal i aprovuar publikohet dhe një kopje dorëzohet ne Departamentin e Buxhetit Komunal/ MEF,

Hapi vijues: Përgatitja e vlerësimeve të hershme 2010 për secilin program udhëhiqet nga secili drejtor i programit

Vlerësimi i saktë i kostos së programeve të aprovuara nga komuna si dhe identifikimi i parametrave që përdoret azhurnimi i tyre shtron nevojën që zyrtari kryesor në bashkëpunim me drejtorët e programeve duhet të përgatisë vlerësimet në përputhje me kufijtë e aprovuar buxhetor 2010.

Hapi 2: Shqyrtimi i prioriteteve për programet komunale

Hapi i dytë kërkon nga Kryetari, ZKF dhe drejtorët që të bëjnë shqyrtimin e çështjeve rreth politikave dhe prioriteteve në fushat e tyre të përgjegjësisë. Programet ekzistuese duhet të vlerësohen në kontekst të objektivave të gjithmbarshme të komunës dhe strategjive sektoriale që janë zhvilluar.

Në pajtim me prioritetet e gjera të Komunës (kur janë në dispozicion), secili program duhet të ofrojë gjithashtu listën përmbledhëse të propozimeve të politikave të reja me prioritet që do të propozohen për procesin buxhetor komunal 2010-2012 (d.m.th, që pritet të fillojnë për çdo vit), bashkë me opsionet për kursimet e mundshme në programet e prioritetit të ulët dhe me performansë të dobët.

Propozimet për shpenzimet e reja kapitale duhet të mbështeten me analizat e përfitimeve dhe kostos së projektit ne pajtim me procedurat e aplikueshme te sistemit PIP dhe në pajtim me prioritetet e komunës.

Propozimi i politikës së re definohet si kërkesë për fonde për (a) programin e ri (përfshirë këtu projektin e ri kapital dhe legjisllacionin e ri që ka implikime); (b) zgjatjet e programeve ekzistuese autoriteti i të cilave është para skadimit; apo (c) zgjerimi i programit ekzistues. Opsioni për kursime mund të jetë (a) reduktimi i propozuar në shpenzime për programin për shkak të efikasitetit të propozuar apo reduktimeve në nivelin e shërbimeve apo (b) anulimi i propozuar i programit që më nuk është i nevojshëm, ka treguar performansë të dobët apo është i prioritetit të ulët.

Shqyrtimi i prioriteteve do t'u mundësojë Drejtorëve që të garojnë në procesin e përcaktimit të prioriteteve në një fazë të hershme të procesit për zhvillimin e buxhetit dhe para se të merren vendimet për kufijtë e fortë buxhetor.

Aktivitetet:

1. ZKF nxjerr Qarkoren buxhetore të brendshme komunale #1 me të cilën ofron instruksionet dhe orarin për kompletimin e shqyrtimit të prioriteteve të programeve,
2. Nga programet kërkohet të përgatisin propozimet e tyre buxhetore dhe shqyrtimin e prioriteteve të programeve si dhe dorëzohen tek ZKF, për vlerësim dhe konsultime me kryetarin e komunës
3. ZKF mban takime konsultative me secilën Drejtor të programeve të komunës. Qëllimi i këtyre takimeve është të kuptohen arsyetimet për programet e reja /iniciativat rreth politikave si dhe kostos indikative (propozimet e programeve duhet të identifikohen thjeshtë si propozime të “një linje” për t'u mundësuar vendimmarrësve që të bëjnë shqyrtimin e shpejtë të nevojave të shfaqura dhe prioriteteve si dhe për të përcaktuar se cilat projekte duhet të zhvillohen më tej gjatë hapave të ardhshëm).

Hapi 3: Kufijtë fillestarë specifik për programet

Në bazë të rezultateve të shqyrtimit të prioriteteve për programet dhe duke vepruar nën drejtimin e kryetarit, ZKF duhet të hartojë dhe të nxjerrë menjëherë qarkoren e brendshme buxhetore komunale #2 për drejtorët e programeve, me të cilat ofrohen informata dhe instruksione mbi kufijtë e shpenzimeve të zbatueshëm për tri (3) vitet fiskale si dhe për metodologjinë dhe formatet që do të përdoren në përgatitjen e kërkesave buxhetore. Qarkorja e tillë buxhetore duhet të përfshijë:

- (a) Procedurat që do të përdoren nga programet në përgatitjen e propozim buxheteve të tyre dhe kërkesave për ndarje të mjeteve buxhetore
- (b) Informatat që duhet të prezantohen në kërkesat e tilla buxhetore
- (c) Hollësitë lidhur me formatin në të cilin duhet të përgatiten kërkesat rreth buxheteve të propozuara dhe
- (d) Orarin dhe datat kalendarike deri në të cilën drejtorët e programeve duhet të kompletojnë dhe të dorëzojnë tek ZKF kërkesat e tyre buxhetore.

Informatat dhe udhëzimet të përfshira në qarkoren buxhetore të brendshme komunale duhet të bazohen në kornizën afatmesme të shpenzimeve të komunës, duke pas parasysh rezultatet e rishikimit të prioritetit të programeve dhe të cilat duhet të përputhen me parimet buxhetore bazë të lëshuara nga MFE.

Me qëllim të ruajtjes së disiplinës fiskale, do të kërkohet që programet komunale t'u përmbahen rreptësishtë kufijve buxhetorë.

Aktivitetet:

1. Kufijtë fillestarë specifik të programeve duhet të përcaktohen para datës 01 korrik 2009
2. ZKF e lëshon Qarkoren e brendshme buxhetore komunale #2 e cila i shpërndahet të gjithë drejtorëve të programeve jo më larg se më 1 korrik 2009, duke u siguruar informata mbi kufijtë specifik të propozuar për programet si dhe instruksione për përgatitjen e propozim buxheteve.

Hapi 4: Dorëzimi i propozim buxhetit komunal sipas programeve

Dorëzimet e materialeve buxhetore janë dokumente përmes të cilave drejtorët bëjnë prezantimin e vlerësimeve të tyre buxhetore dhe propozimeve të hollësishme të politikave të reja si dhe opsioneve për kursime në kontekst të strategjisë afatmesme fiskale (dhe në pajtim me kufijtë fillestar buxhetor). Me shfrytëzimin e vlerësimeve të hershme, duke njohur faktin që shumica e programeve komunale vazhdojnë nga një vit në tjetrin, në fokus të marrjes së vendimeve rreth buxhetit do të jenë propozimet për programet shpenzuese të reja dhe plotësuese si dhe ato që u nënshtrohen kursimeve potenciale në kontekst të pozitës aktuale fiskale.

Zyrat komunale të tatimit në pronë duhet të bëjnë rekomandimet e tyre në vendosjen e zonave të vlerësimit dhe normave tatimore me qëllim të arritjes së të hyrave të vlerësuara të tatimit në pronë të parapara me buxhet.

Aktivitetet:

1. Programet komunale do të përcjellin materialet e tyre buxhetore tek ZKF deri në datën e specifikuar me Qarkoren e brendshme buxhetore komunale #2.

Hapi 5: Dëgjimet buxhetore

Kur të ketë kaluar afati kohor i specifikuar me Qarkoren e brendshme buxhetore komunale #2, ZKF në konsultim me Kryetarin e Komunës do (i) të shqyrtojë buxhetet e propozuara që janë dorëzuar nga programet, dhe (ii) do të mbaj seanca dëgjimore për secilin program me qëllim të shqyrtimit dhe të kuptuarit të buxheteve të propozuara, me qëllim të përpjekjes për zgjidhjen e çështjeve dhe shqetësimeve lidhur me buxhetet e propozuara, veçmas për sa i përket pajtueshmërisë së tyre me kufijtë fillestar specifik të programeve.

Aktivitetet:

1. ZKF nxjerr Qarkoren e brendshme buxhetore #3 në të cilën ofrohet orari kohor dhe kërkesat për dëgjimet buxhetore komunale,
2. Dëgjimet buxhetore për të gjitha programet duhet të mbahen në pajtim me orarin kohor,
3. Dëgjimet buxhetore duhet të paralajmërohen me kohë dhe të zhvillohen si takime të hapura me publikun.

Hapi 6: Përgatitja e dokumentacionit buxhetor

Pas mbajtjes së dëgjimeve buxhetore dhe takimeve të hapura me publikun, ZKF do të përgatisë dhe dorëzojë Kryetarin të Komunës buxhetin e propozuar komunal për secilin nga tri (3) vitet vijuese fiskale në formatin që është në përputhje me instruksionet e përfshira në Qarkoren buxhetore të MEF si në listën e dokumenteve për dorëzim të buxhetit. ZKF në të njëjtën kohë bën shpërndarjen e buxhetit të propozuar për drejtorët e programeve, për vitin e ardhshëm fiskal.

Hapi 7: Shqyrtimi i buxhetit të propozuar komunal nga ana e Kuvendit Komunal

Kur Kryetari i Komunës të ketë aprovuar buxhetin e propozuar komunal për tri vitet e ardhshme fiskale, përfshirë këtu dokumentet përcjellëse ashtu si kërkohet nga MEF, Kryetari i Komunës bën dorëzimin e dokumenteve të buxhetit të propozuar në Kuvendin Komunal për shqyrtim/diskutim dhe aprovim. Dokumentacioni përmbledhës i buxhetit për publikim, shpërndarje dhe shfrytëzim nga ana e Kuvendit Komunal dhe opinionit publik gjithashtu do të dorëzohet së bashku me dokumentacionin e detajuar të buxhetit.

Në këtë dokumentacion përmbledhës buxhetor duhet përfshirë edhe rregulloret komunale që vendosin zonat e vlerësimit dhe normat tatimore, të cilat paraprakisht do të debatohen dhe të aprovohen nga asambltetë komunale.

Lista e dokumenteve obligative buxhetore është e përfshirë në Pakon e Buxhetit Komunal (shih **Shtojcën M**).

Kuvendi Komunal bën shqyrtimin e tyre në takimin e rregullt të radhës apo në ndonjë takim special të ftuar më herët, me qëllim të shqyrtimit të atyre dokumenteve. Rekomandohet që Kuvendi Komunal të organizoj takim të veçantë të paralajmëruar, ku nga opinionit publik kërkohet kontributi në lidhje me buxhetin, si dhe shqyrtimin dhe aprovimin e tij. Ky takim duhet të mbahet në prezencën e mediave, derisa propozim buxheti komunal prezantohet nga Kryetari i Komunës.

Aktivitet:

1. Buxheti i propozuar komunal për vitin 2010 dhe informatat përcjellëse do të dorëzohen për aprovim në Kuvendin Komunal, jo më vonë se më **01 Shtator 2009**.
2. Kuvendi Komunal duhet ti organizoj takimet publike të reklamuar mirë me qëllim të sigurimit të kontributit të opinionit publik për shqyrtimin e buxhetit komunal dhe rishikimin e tij, ashtu si shihet e përshtatshme.

Hapi 8: Arovimi i buxhetit të propozuar komunal nga Kuvendi dhe dorëzimi në MEF

Pas dëgjimeve buxhetore Kuvendi i Komunës duhet të rishikoj, modifikoj po qe se është e nevojshme, aprovoj dhe të dorëzoj tek kryetari i komunës buxhetin e propozuar komunal për vitin 2010-2012.

Posa të jetë aprovuar nga Kuvendi Komunal, Kryetari i komunës pakon e propozuar të buxhetit komunal dhe dokumentacioni përcjellës duke përfshirë edhe rregulloret e tatimit në pronë, duhet ta dorëzoj në Departamentin e Buxhetit të Komunave në MEF. Propozim buxheti i aprovuar komunal dhe kërkesat për ndarjet buxhetore duhen të jenë në pajtueshmëri të plotë me rregullat dhe instruksionet e lëshuara në Qarkoret buxhetore nga MEF. Gjithashtu kryetari i komunës duhet ta publikoj propozim buxhetin në ueb faqen zyrtare të Komunës. Në pajtim me synimin për transparencë dhe përgjegjshmëri fiskale, dokumentet buxhetore do të vihen në dispozicion të publikut.

Aktivitetet:

1. **Propozim buxheti komunal duhet aprovuar nga Kuvendi Komunal jo më vonë se 30 Shtator 2009.**

2. Propozim buxheti komunal për vitin 2010 i aprovuar nga Kuvendi Komunal duhet të jetë i nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe të dorëzohet në Departamentin e Buxhetit të Komunave në MEF menjëherë, në kopje fizike dhe në formën elektronike, në tri gjuhë, dhe vendimin zyrtar të aprovuar nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës).

5. Trajnimet dhe informatat plotësuese

Departamenti i Buxhetit të Komunave në MEF do të ofrojë trajnime për komunat lidhur me zhvillimin e buxheteve komunale për vitin 2010-2012. Trajnimet do të ofrojnë një pasqyrë të përgjithshme të proceseve të reformuara për zyrtarët e buxhetit. Trajnimi shtesë do të përfshijë module më specifike trajnuese për secilën nga fazat kyçe të buxhetit. Orari dhe agjenda për trajnimet përkatëse do të ofrohet komunave nëpërmes të një kumtese tjetër.

6. Shpërndarja transparente e Qarkores Buxhetore në nivelet komunale

Autoritetet komunale janë të obliguara ta shpërndajnë këtë Qarkore Buxhetore tek të gjithë zyrtarët komunal të angazhuar në procesin e hartimit të buxhetit. Të gjitha autoritetet komunale janë përgjegjëse për organizimin kohor të angazhimeve dhe aktivitetëve të tyre në përputhje me orarin e hartimit të buxhetit, në mënyrë që ta mbështesin plotësisht përgatitjen e buxhetit, respektimin e udhëzimeve buxhetore, përfundimin dhe aprovimin si dhe dorëzimin me kohë të buxheteve komunale.

SHTOJCAT:

Shtojca A - Detajet e formulave për alokimin e granteve specifike të Arsimit dhe Shëndetësisë

Shtojca B - Grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2010-2012

Shtojca C - Qëllimi dhe strategjia për grantet qeveritare

Shtojca D - Projektionet e të hyrave vetanake nga Komunat për vitet 2010-2012

Shtojca E - Formulari për të hyrat vetanake komunale 2010-2012

Shtojca F – Struktura e buxhetit komunal - Tabela 2B

Shtojca G – Tabela e shpenzimeve dhe të hyrave - Tabela 2B 1

Shtojca H – Kufijtë për stafin, pagat e mëditjet dhe shpenzimet operative për vitin 2010

Shtojca I - Tabela e projekteve kapitale për komunat për vitin 2010-2012 -Tabela 3B

Shtojca J - Deklarata për misionin dhe performansën sipas programeve/drejtorive

Shtojca K - Klasifikimi ekonomik i shpenzimeve, kodet ekonomike
(plotësimi i UA 2005/08 të thesarit, Prill 2009)

Shtojca L - Financimi nga donatorët

Shtojca M - Pakoja e dokumenteve të propozim buxhetit komunal për vitin 2010-2012

Shtojca A – Detajet e formulave për alokimin e granteve specifike të Arsimit dhe Shëndetësisë

1. Kriteret e Formulës për kalkulimin e grantit specifik të Arsimit

Formula duhet ti alokojë shumicën e fondeve në bazën për kokë nxënësi². Kalkulimi i nevojave për shpenzime në çdo komunë është i ndarë në 4 kategori të shpenzimeve: pagat e mësimit, pagat e personelit administrativ dhe ndihmës, mallërat dhe shërbimet, duke përfshirë shpenzimet e punëve dhe mirëmbajtjes, si dhe kapitalet.

Alokimi i mësimit me normë të plotë (NP)

Alokimi për paga të mësimit është numri normativ i mësimit me normë të plotë të kalkuluar përmes formulës për çdo komunë i shumëzuar me shpenzimet për pagë mesatare të mësimit për komunë.

Numri i mësimit me normë të plotë përcaktohet përmes:

- (i) numrit të orëve në vit që nxënësit duhet ti vijojnë në çdo klasë sipas planprogramit shtetëror, të ndarë me numrin e javëve të mësimit në vit për të fituar numrin e orëve në javë³: veçohen katër kategori të nxënësve në formulë:
 - para fillor (duke përfshirë moshat 5 dhe 6 vjeçare në shkollat fillore)
 - fillor (klasët 1-9)
 - arsimit të mesëm të përgjithshëm (gjimnazi) klasët 10-13
 - e mesëm profesional në klasët 10-13.
- (ii) numri i orëve në javë që mësimit duhet ti mbajnë në mënyrë që të marrin pagën e plotë;
- (iii) shpenzimet për pagë mesatare për një mësimit me normë të plotë. Përqindja e mësimit në nivele të ndryshme të pagave të prezantuar përmes licencimit të mësimit është e ndryshme nëpër komuna. Prandaj, formula kalkulon sasinë e mjeteve të alokuara për paga të mësimit në çdo komunë në bazë të një vlerësimi të shpenzimeve për pagë mesatare të një mësimit në komunë.

Parametrat që e përcaktojnë numrin e kërkuar të mësimit me NP për kokë nxënësi dhe inversin e tij, raportin nxënës-mësimit janë paraqitur në tabelën 1. Orët në javë për mësimit dhe orët në javë për nxënës janë të përcaktuara me udhëzime administrative.

² Nxënësit me nevoja të veçanta të arsimit aktualisht janë lënë jashtë formulës gjithashtu edhe shpenzimet për konvikte.

³ Nxënësit e shkollave profesionale kanë 35 javë mësimit dhe 2 javë në vendin e punës, sidoqoftë mësimit janë ende të përfshirë në mbikëqyrje. Prandaj llogariten 37 javë mësimit për të gjithë nxënësit.

PARAMETRI	Nxënësit para-shkollor	Nxënësit e sh. fillore 1-9	Nxënësit e sh. mesme	Nxënësit e sh. profesionale
Raporti nxënës mësimitshënës i propozuar për vitin 2010 për komunitetin shumicë	12.0	21.3	21.3	17.2
Raporti nxënës mësimitshënës i propozuar për vitin 2010 për komunitetin pakicë	12.0	14.2	14.2	14.2

Raporti nxënës-mësimshënës (RNM) i dikton shpenzimet për nxënës. Shpenzimet e pagave të mësimshënësve për nxënës janë:

- (i) nxënësit para-fillor: 12 nxënës për mësimshënës⁴
- (ii) nxënësit e shkollave profesionale: 17.2 nxënës për mësimshënës⁵.

Raportet tjera nxënës-mësimshënës janë të njejtë me vitin 2009

Kalkulimi i shpenzimeve të pagave të mësimshënësve

Mësimshënësit		
Numri i nxënësve: Shumicë Pakicë	÷	Raporti nxënës mësimshënës (RNM) Shumicë Pakicë
Totali i pagave të fillores = Numri i mësimshënësve me normat e plota X paga mesatare e mësimshënësve në komunë		

Paga mesatare e mësimshënësit në një komunë varet nga shpërndarja e mësimshënësve sipas kualifikimit dhe përvojës. Duke përdorë të dhënat nga lista e pagave, u identifikuan 5 nivele të pagave të mësimshënësve në çdo komunë, dhe duke përdorë këtë u llogarit paga mesatare e mësimshënësit për 2008/9 dhe u aplikua në kalkulimet grantit për arsim në 2010.

⁴ RNM për nxënësit pakicë (përveç atyre para-fillor) zvogëlohet për 1/3. Nxënësit pakicë janë nxënës të një komune që mësojnë në gjuhën e minoritetit për atë komunë. Shqiptarët dhe serbët mund të jenë nxënës shumicë ose pakicë, varësisht nga komuna. Për shkak të numrit të vogël të nxënësve pakicë, paralelet janë më të vogla, prandaj edhe RNM është më e ultë se për nxënësit shumicë.

⁵ Planprogrami për arsim profesional është rishikuar nën udhëzimin administrativ nr.26/2008, të datës 19.08.2008(Udhëzimi administrativ për zbatim të planit dhe programit për arsim profesional, Fusha: Administrata për nivelin e parë, Kl X, XI). Kjo specifikon 32 orë mbi 35 javë, por gjithashtu përfshin edhe paralelet e praktikës të cilat duhet të mbajnë orët në grupe më të vogla rreth 13 nxënës. Mesatarisht gjatë fazës së dytë nxënësit profesional kalojnë 1/3 e kohës së tyre në orë të praktikës. Nxënësit profesional kanë nevojë për një RNM më të ultë se 21.3, gjë të cilën formula aktuale shtetërore e kalkulon për të gjithë nxënësit e shkollave të mesme, në mënyrë që të merret parasysh 1/3 e orëve në paralele me madhësi prej 15 nxënësve. Një RNM prej 17.2 për nxënësit profesional nxirret duke llogaritur se në 2/3 e orëve të tyre nxënësit profesional janë në të njejtën paralele sikur edhe nxënësit e gjimnazit (32) dhe në 1/3 e orëve janë në paralele prej 15 nxënësish. Prandaj madhësia mesatare e llogaritur e paraleles është 26.3. Kur kemi parasysh një mesatare prej 29.6 orëve në javë dhe 20 orë për mësimshënës, **RNM për shkolla profesionale do të rezultojë me 17.2.**

Kalkulimi i shpenzimeve për personelin administrativ dhe ndihmës

Rekomandohet fuqishëm që formula e vitit 2010 ta ndërpresë alokimin e pagave për këto pozita në bazë të numrit aktual të personelit në pozitë. Kjo është rregulla e alokimit joefikas pasi që i penalizon komunat të cilat e zvogëlojnë punësimin e personelit dhe kështu i dekurajon komunat që të bëhen më efikase në shpërndarjen e personelit.

- (i) Një drejtor shkolle për një shkollë amë.
- (ii) Një administrator për 675 nxënës të sh. fillore dhe një për 640 nxënës të sh. mesme. Këto raporte u përzgjedhën sepse përdorimi i tyre alokon në total përafërsisht numrin e njëjtë total të personelit administrativ në të dy sektorët sikur se ishte alokuar nga granti për arsim i 2009.
- (iii) Alokimet e pagave për personelin administrativ përcaktohen duke shumëzuar numrin e personelit administrativ të sh. fillore me pagën vjetore të personelit administrativ të sh. fillore. Kjo paraqet rritjen për 10% të nivelit të pagave që u përdorë në kalkulimet e grantit për arsim 2009. Kalkulimi i njëjtë përdoret edhe për shpenzimet e personelit administrativ të sh. mesme.

Udhëzimet administrative të MASHT-it⁶ i specifikojnë vetëm pastruesit dhe rojet e shkollës si personel ndihmës, për të cilin kanë të drejtë shkollat. Pozitat e tjera janë opcionale. Prandaj, formula alokon:

1 roje për shkollë (amë dhe paralele të ndarë)

1 pastrues për 170 nxënës.

Pastruesit alokohen sipas numrit të nxënësve dhe jo sipas sipërfaqes së objektit shkollor, meqenëse kjo është më e drejtë dhe më efikase. Është më e drejtë sepse alokimi i pastruesve sipas sipërfaqes nuk u jep komunave me shkolla me më shumë ndërrime më shumë mjete në krahasim me komunat me më pak ndërrime në bazë të numrit të nxënësve. Një pastrues për 170 nxënës plus 1 roje për çdo shkollë jep pothuajse numër të njëjtë të personelit të përgjithshëm ndihmës siç është alokuar sipas grantit të arsimit 2009.

Kategoria e **Mallrave dhe shërbimeve** si dhe **kapitalet** janë të alokuara sipas numrit të shkollave dhe nxënësve, si në formulën e vitit 2009. Sidoqoftë, vetëm shkollat amë që përkufizohen si shkolla amë në formulën e vitit 2009 përfitojnë shumën e poshtëpërmendur bazë, dhe për të shtuar efikasitetin paralelet e ndara nuk do të përfitojnë shumë fikse për shkollë. Rrjedhimisht, sasia e mjeteve për shkollë rritet në 1500 euro për shkollat para-fillore dhe fillore dhe 3250 euro për shkollat e mesme. Mallrat dhe shërbimet për nxënës kanë mbetur të njëjta (23 euro për çdo nxënës të komunitetit shumice dhe 25 euro për çdo nxënës të komunitetit pakice) si dhe kapitalet për 7 euro për çdo nxënës.

2. Kriteret e Formulës për kalkulimin e grantit specifik të Shëndetësisë

Formula e rekomanduar e Shëndetësisë e zhvilluar në bashkëpunim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Bankës Botërore, është si bazë për kalkulimin dhe alokimin e granteve duke marrë si bazë për koke banori. Formula për kokë banori, e cila përfshinë edhe përshtatjen për moshë dhe gjini, mbështet një mesatare prej mesatarisht 2.8 vizitave shëndetësore për person gjatë vitit me një kosto prej 3.8 eurove për vizitë dhe 5% të rezervës për të futur sistemin e pagesës në bazë të performancës në sistemin shëndetësor.

Alokimi komunal = Popullata (bazuar në LFPL) * 2.8 vizita (mesatare) * 3.8 euro (mesatarja për vizitë; në të ardhmen do të përfshihet edhe diferencimi i moshës dhe gjinisë).

⁶ Udhëzimi administrativ i MASHT-it [1] 16/2002 i datës 17 tetor 2002.

Shtojca B – Grantet qeveritare për financimin fillestar të komunave për vitin 2010-2012
(Shih me poshtë tabelat e granteve qeveritare për komunat, gjithashtu të publikuara në ueb faqen e MEF-it)

Financimi Komunal për vitin 2010 - Grantet dhe të Hyrat vetanake

Komunat	Granti i Përgjithshëm	Granti specifik i Arsimit - 2010			Granti specifik i Shëndetësisë - 2010			Granti specifik për shërbime sociale	Projeksiioni i të hyrave vetanake komunale - 2010	TOTAL FINANCIMI KOMUNAL - 2010
		Granti specifik i Arsimit - 2010	Mësimdhënësit shtesë (vendimi i qeverisë)	Total Granti specifik i Arsimit - 2010 përfshirë mësimdhënësit shtesë	Granti Specifik i Shëndetësisë	5 % e Performancës	Total - Granti Specifik i Shëndetësisë (përfshirë 5 % të performancës)			
Kalkulimet >>	a	b	c	d = b + c	e	f	g=e+f	h	i	j = a+d+g+h+i
1 Deçan	1,715,400	2,034,646		2,034,646	426,737	21,337	448,074	49,474	500,641	4,748,235
2 Dragash	1,887,639	1,551,916		1,551,916	369,698	18,485	388,183	48,491	356,891	4,233,120
